VENDIM
Nr. 229, datë 28.10.2024

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "SPV BLUE 2" SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA PARKU FOTOVOLTAIK "BLUE 2"

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a", dhe 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa "a" të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.10.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2144/1 prot., datë 25.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve "Mbi kërkesën e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2144 prot., datë 16.10.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik "Blue 2", me vendndodhje në Sheq Marinas, me kapacitet të instaluar 50 mw.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, germat "a" "b" dhe "c"; për pikën 1.2, germat "a", "b", "c" dhe "d"; për pikën 1.3, germën "c"; për pikën 2.1 germat "b", "c", "d", "e" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria "SPV Blue 2" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) Kontratën nr. 2721 rep., nr. 2067 kol., datë 9.7.2021, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike 'Blue 2' me kapacitet të instaluar 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk përfiton nga masat mbështetëse, në zonën Sheq Marinas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqërisë 'SPV Blue 2' sh.p.k.";

- Ka nënshkruar me shoqërinë "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST) sh.a. "*Marrëveshjen për lidhjen në rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaik Blue 2"*, me nr. 2391 prot., datë 13.4.2022.

- Është pajisur me VNM paraprake (transferim vendimi nga AN051220200007 – "Blessed Investment" sh.p.k. në AN160720210002 – "SVP Blue 2" sh.p.k.), lëshuar më 3.2.2021 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin "*Parku Fotovoltaik Blue 2*", për shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k. Kjo VNM ka qenë e vlefshme deri më datë 3.2.2023, ndaj shoqëria duhet të dokumentojë që ka filluar punimet brenda datës 3.2.2023, ose të depozitojë një VNM të re.

- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni në vijim:

NENI 9

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **germa "a":** aplikuesi duhet të depozitojë vërtetimin që nuk ka detyrime të pashlyera ndaj organit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

- **germa "b":** aplikuesi duhet të depozitojë në ERE vendimet e organeve drejtuese të ortakëve të saj, ku të përcaktohet vënia në dispozicion e fondeve për realizmin e projektit të parkut fotovoltaik "Blue 2".

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1

- **germa "a":** aplikuesi duhet të bëjë plotësimet përkatëse në lidhje me numrin e njësive gjeneruese dhe kapacitetin e secilës, vitin e ndërtimit dhe datën e fillimit të operimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "SPV Blue 2" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga parku fotovoltaik "Blue 2", me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në Sheq Marinas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë "SPV Blue 2" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti